

Raporti Perfundimtar
Per
Vleresimin e punes se kryer ne
Sektorin e Menaxhimit te Burimeve Njerezore
Bashkia Devoll

I. PERMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Mbeshtetur ne ligjin nr. 114 date: 22/10/2015 ”Per auditimin e brendshem ne sektorin publik”, Manualit te auditit te brendshem te miratuar me urdherin nr.100 Date:25.10.2016 te Ministrit te Financave, planin vjetor te auditit te brendshem nr.prot 2610/1 date 16.10.2018 te miratuar nga kryetari i bashkise Devoll, njoftimin per fillimin e angazhimit te auditimit nr 744 Prot, date 25.02.2019 “Mision auditimi Perputhshmerie ne **Sektorin E Burimeve Njerezore**”,u krye gjate periudhes 26.02.2019-29.03.2019,per periudhen nga data 01.06.2017-31.12.2018.Auditimi u krye nga specialisti ne zyren e Auditimit te Brendshem.

Misioni i ketij auditimi eshte qe te ndimoje **Sektorin e Menaxhimit te Burimeve Njerezore** ne realizimin e objektiveve te veprimtarise duke permiresuar sistemet e kontrollit dhe performances. Nga auditimi i kryer ne **Sektorin e Menaxhimit te Burimeve Njerezore**, eshte vleresuar ne teresi sistemi ne perputhje me udhezimet dhe metodikat me qellim qe sistemi i kontrollit te njesise te audituar,te jete transparent dhe ne perputhje me normat e ligjshmerise, rregullshmerise, frytshmerise dhe kursimit.Jane realizuar te gjitha pikat e programit te pergatitura nga specialistet e auditit.

Qellimi i angazhimit te auditimit eshte vleresimi dhe dhenia e sigurise objektive,te pavarur mbi veprimtarine ne **Sektorin e Menaxhimit te Burimeve Njerezore** per te vleresuar efektivitetin dhe eficencen per arritjen e objektiveve te menaxhimit financiar dhe kontrollit te brendshem dhe njekohesisht dhenia e rekomandimeve per permiresimin e sherbimit.

Sipas tematikes se percaktuar ne programin e auditimit analizuam dhe vleresuem veprimtarine e e Sektorit te Burimeve Njerezore per periudhen 01.06.2017 deri 31.12.2018,duke ekzaminuar ne vecanti te gjitha dokumentat ,proces verbalet,vendimet qe dispononte ky sektor .

Ne perfundim te auditimit ne **Sektorin e Menaxhimit te Burimeve Njerezore** jane kostatuar shkelje te akteve ligjore dhe nenligjore qe kane te bejne me mosplotesimin e struktures organike te miratuar cdo fillim viti me VKB,mos dorezimin e listprezencave te punonjesve prane Sektorit te Burimeve Njerezore nga Drejtuesit e Sektoreve,Agjensive,Drejtorive,ne hartimin e pershkrimeve te punes,ne vleresimin e punonjesve te Sherbimit Civil,ne komandimin dhe delegimin ne pozicione drejtuese.

-Ne sistemin e mosplotesimit te struktures organike u kostatua se gjate kesaj periudhe shume pozicione pune te miratuara me urdher te kryetarit te bashkise qofshin ato ne nivel drejtues apo specialiste te thjeshte nuk jane plotesuar. Konkretisht duhej qe keto pozicione pune duhej te ishin plotesuar nepermjet shpalljes se procedurave te rekrutimit.

-Ne sistemin e mosdorezimit te listprezencave u kostatua se me gjithe kerkesen e specialistes se sektorit te menaxhimit te burimeve njerezore asnje sektor,drejtori apo agjensi nuk depoziton prane ketij sektori lisprezencen e punonjesve cdo fund muaji perpara se te hartohet lisprezenca perfundimtare nga specialistja e ketij sektori.

-Ne sistemin e hartimit te pershkrimeve te punes u kostatua se pershkrimet e punes qe duhet te hartoeshin per secilin pozicion nga zyrtari raportues per nepunesin qe mbikëqyr në mënyrë të drejtpërdrejtë në linjën e hierarkisë organizative nuk jane hartuar.Pra nuk jane hartuar pershkrimet e vendit te punes te harmonizuara me procedurat e punes.

-Ne sistemin e vleresimit te punonjesve te sherbimit civil u kostatua se ne disa raste vleresimi i punes se nenpunesit civil nuk ishte bere nga nga zyrtari raportues si nenpunesi qe mbikëqyr ne mynyre te drejtperdrejte ne linjen e hierarkise organizative nenpunesin qe do te vleresohet por ishte bere nga zyrtar autorizues.

-Ne sistemin e krijimit te nje database,per regjistrimin e levizjeve te punonjesve (emerime,largime,kalim ne detyre tjeter apo levizje paralele) u kostatua se sektori nuk ka akoma nje database te tille per te lehtesuar punen e rekrutimeve dhe levizjeve.

-Ne sistemin e lenies dhe marjes se detyres u kostatua se vetem paisjet dhe materialet e punes dorezohen me procesverbal ndersa dokumentacioni jo.

VI. Rekomandimet

Ne perfundim te procesit te vleresimeve te bera nga specialistet e auditimit per personat pergjegjes bazuar ne nenin 6 pika c e Ligjit nr 114/2015 date 22.10.2015 “Per auditimin e brendshem ne sektorin publik” per aritjen e objektivave te **Sektorit te Burimeve Njerezore** si dhe per te ritur efektivitetin ne punen funksionimin dhe drejtimin e ketij sektori, **rekomandojme.**

1. Te plotesohet menjehere struktura organike duke filluar me shpalljen e menjehereshme te procedurave te rekrutimit.

***Personi pergjegjes: Specialisti i Sektorit te
Burimeve Njerezore(ne mungese te pergjegjesit)***

Afati: Brenda muajit Qershor 2019

2. Specialistja e Burimeve Njerezore te hartoje ne forme urdheri me miratimin edhe nga titullari kerkesen per dorezimin e lisprezencave.

***Personi pergjegjes: Specialisti i Sektorit te
Burimeve Njerezore(ne mungese te pergjegjesit)***

Afati: Menjehere

3. Te dorezohet prane Sektorit te Menaxhimit te Burimeve Njerezore cdo fund muaji lisprezenca e punonjesve nga cdo Sektor, Drejtori apo Agjensi.

Personat pergjegjes: Pergjegjesat e sektoreve

Drejtoret e Agjensive.

Afati: Menjehere

3.Cdo fillim viti perpara miratimit te regullores se brendeshme te Bashkise Devoll cdo punonjes duhet te hartoje pershkrimet e vendit te punes te azhornuara me legjislacionin perkates te cilat me pas do te permblidhen ne kete regullore.

Personat pergjegjes: Punonjesit e cdo pozicioni pune

Afati:Ne vazhdimesi

4.Ne cdo rast vleresimi i rezultateve ne pune per nenpuneshin civil te kategorise ekzekutive,te ulet dhe te mesme drejtuese te kryhet bashkarisht nga zyrtari raportues,zyrtari kunderfirmues dhe zyrtari autorizues.

Personat pergjegjes: Zyrtari raportues,zyrtari kunderfirmues

Zyrtari autorizues

Afati:Ne vazhdimesi

5.Te hartohet nja database per regjistrimin e levizjes se punonjesve(emerime,largime,kalim ne detyre tjeter apo levizje paralele)

Personi pergjegjese: Specialistja e Sektorit

te Burimeve Njerezore

Afati:Shtator 2019

Specialisti i Auditit te Brendshem